VENDIM
Nr.588, datë 30.8.2006

PËR DËRGIMIN NË PARIS, FRANCË, TË 5 IKONAVE, OBJEKTE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TË LUAJTSHME, ME VLERA TË VEÇANTA, PËR EKSPOZIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin, në Paris, Francë, të 5 ikonave, objekte të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta, së bashku me dokumentacionin përkatës identifikues, për t'u ekspozuar, në selinë e UNESKO-s, në veprimtarinë "Ditë të trashëgimisë kulturore shqiptare në Paris".

2. Koha e qëndrimit të këtyre objekteve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të jetë nga data 30 gusht 2006 deri më 16 shtator 2006.

3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha